



Republika e Kosovës
KOMUNA E MALISHEVËS

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Datë:10.07.2017

Nr. 10/

PËR:	z. Ragip Begaj , Kryetar i Komunës
NGA:	Sejdi Paçarizi , Drejtori i DMSH
LËNDA:	Raport i punës së DKMSH-së për periudhën Janar-Korrik 2017-

I nderuar,

Bashkngjitur gjeni raportin e punës së Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për vitin periudhën Janar-Korrik' 2017.

Me nderime!



Republika e Kosovës
KOMUNA E MALISHEVËS

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

RAPORTI I PUNËS SË DREJTORISË PËR
MBROJTJE DHE SHPËTIM PËR
PERIUDHËN JANAR - KORRIK' 2017

Qershor'2017

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, edhe gjatë kësaj periudhe, ka qenë bartëse e aktiviteteve në përgaditëjen dhe menaxhimin e emergjencave në territorin e komunës së Malishevës, dhe e cila ka menaxhuar dhe koordinuar me sektorët mvarës në kryerjen e punëve dhe detyrave të parashtruara sipas planit të punës për vitin 2017, dhe në përputhëshmeri me Ligjet, dhe Urdhëresat Administrative që janë në fuqi. Të gjitha sektorët e kësaj Drejtorie i kanë kryer punët dhe detyrat e parapara me kohë dhe me sukses.

Kjo periudhë karakterizohet me Situata Emergjente (SE), si pasojë e fatkeqësive natyrore, gjegjësishtë, vërshimeve dhe erërave të forta (stuhi), që kanë goditur territorin e komunës së Malishevës në muajin Janar, Mars dhe Qershor, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në Bujqësi, Infrastruktur dhe Ekonomi.

Vlenë të theksohet se si pasojë e këtyre SE, nuk ka patur humbje të jetës dhe as lëndime të rënda në njerëz.

- Freskimi i Planit të Vlerësimit të Rrezikut për territorin e Komunës së Malishevës me të dhëna të reja;
- Freskimi i Planit të Reagimit për komunën e Malishevës me të dhëna të reja;
- Përgaditja dhe mbajtja e takimeve të Këshillit të Sigurisë së Bashkësive në Komunitet.
- Vijimi i trajnimeve profesionale të stafit të drejtorisë,
- Gadishmeria dhe menaxhimi i personelit të Drejtorisë, gjatë Rasteve Emergjente.
- Përgaditja, implementimi dhe monitorimi i projektit për masat parandaluese ndaj etheve hemoragjike, (spërkatja selektive e zonave endemike gjatë muajit Maj dhe Qershor'2017, e kryer nga firma e kontraktuara nga Komuna e Malishevës.
- Themelimi dhe aktivizimi e Njësitit për Mbrojtje dhe Shpëtim për sezonin veror,(vezhgimin dhe shuarjen e zjarrit).
- Vazhdimi i punës në hartimin e POE për komunën e Malishevës,
- Pjesëmarrja e personelit në Komisionin Komunal për Vleësimin e Dëmeve konform QRK,
- Pjesëmarrja e personelit në menaxhimin e kontratave nga ZKA,
- Përgaditja e ushtrimit fushor "MIRUSHA 2017",
- Inspektimi i Rasteve Emergjente,

janë këto aktivitetet në të cilat ishte vënë fokusi i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë këtij periudhe, gjë që edhe ka rrezolltuar që të mos kemi asnjë rast me fatalitet në popullatë.

Sektori i Planifikimit Emergjent; edhe gjatë këtijë viti, ka vazhduar të jetë elementi themelor në identifikimin e shaktareve të rrezikut, evidentimin dhe parandalimin e tyre, si dhe hartimin e planeve relevante.

Sektori i Planifikimit Emergjent, gjatë kësajë periudhe, ka kryer punët në:

- Freskimin e Planit të Vlerësimit të Rrezikut për territorin e Komunës së Malishevës me të dhëna të reja.
- Freskimin e Planit të Reagimit për komunën e Malishevës, Inspektimin e Rasteve Emergjente,
- Përgaditjen e planprojekteve për marrjen e masave parandaluese ndaj rreziqeve për sezonin veror (zjarret, etheve hemoragjike etj.)
- Përgaditjen për mbajtjen e takimeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
- Menaxhimi i projektit të spërkatjes selektive të territorit të komunës së Malishevës ndaj EHKK nga kompania e kontraktuar,
- Hartimin e Planit Operativ Emergjent,
- Përgaditja e ushtrimit fushor “MIRUSHA 2017”,
- Hartimi i planprojekteve,
- Menaxhimi i projekteve.

Sektori për Informim dhe Alarmim; gjatë kësajë periudhe, nuk i ka kryer detyrat e veta të parashtruara sipas ligjit, rregulloreve, udhëzimeve administrative që janë në fuqi dhe urdhërave dhe urdhëresave. Zyra e Alarmimit dhe Koordinimit Emergjent (ZAKE) në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjithashtu edhe gjatë kësajë periudhe, ka qenë dashtë të jetë elementi themelor i informimit, vëzhgimit dhe të alarmimit në territorin e Komunës së Malishevës.

Radiorrjeti komunal “Kalaja”, gjatë kësajë periudhe nuk ka funksionuar për shkak të huazimit të mjeteve të radiokomunikimit Shoqatës së Gjahtarëve “UJËVARA” në Malishevë.

Megjithatë, edhe gjatë kësajë periudhe, është vazhduar të mbahen kontaktet e vazhdueshme me qendra tjera të alarmimit të të gjitha niveleve të Kosovës.

Sektori i Preventivës ndaj zjarrit dhe hulumtimit; gjatë kësajë periudhe, duke u bazuar në planprogramin e punës për vitin 2017, ka kryer këto aktivitete nga fushëveprimi i mbrojtjes nga zjarri.

- Inspektime të rregullta në objekte publike dhe private.
- Dalje në vende të ngjarjes për hulumtimin e shkaqeve të shpërthimit të zjarreve.
- Lëshimi i pëlqimeve për mbrojtje nga zjarri në dokumentacionin investivo teknik për ndërtimin e objekteve.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer inspektime të rregullta në objekte të impianteve për shitjen e derivateve të naftës dhe butan gazit, objekte industriale, hotele, qendrave tregtare, lokaleve afariste, institucioneve shkollore dhe shëndetësore.

- Në bashkëpunim me hetuesit e stacionit policor kemi dal në vendet e ngjarjes për hulumtimin e shkaqeve të shpërthimit të zjarrit.

Në vazhdim janë të evidentuara inspektimet gjatë kësaj periudhe kohore:

1. Inspektime të rregullta.....	8,
2. Inspektimet kontrolluese.....	8,
3. Masat të propozuara.....	10,
4. Në sektorin publik.....	5,
5. Në sektorin privat.....	5,
6. Dalje në vendin e ngjarjes për hulumtimin e shpërthimit të zjarrit.....	11 raste.

Gjatë periudhës në vazhdim , sektori i parandalimit do të vazhdoj punën sipas planit vjetor në kryerjen e punëve të inspektimeve të rregullta dhe kontrolluese, dalje në vendin e ngjarjes për hulumtimin e shkaqeve të shpërthimit të zjarreve, dhënien e pëlqimeve, dhe punët tjera të cilat kërkohen nga Drejtoria.

Njësitë për Zjarrëfikje dhe Shpëtim (NjPZSH):

NjPZSH gjatë kësaj periudhe ka kryer detyrat sipas përshkrimit të vendeve të punës , planit të punës ,Rregullores së NjPZSH ,Rregullores nr .0.39 të AME. dhe atë me shume sukses jan arritur objektivat, ku qellimi kryesor ka qen qe sa ma mire te dalim para opinionit në lufte kunder zjarrit dhe ate ne grupe apo ekipe .Kemi aplikuar standardet por ne mungese te personelit ,nuk kemi arrit ne tëresi te perbushim ato.

NjPZSH , në këtë gjashtë mujor ka pasur gjithsej **82** dalje, dhe atë:

- Intervenimet:

1. Zjarre: 49

- Zjarre në objekte ndertimore dhe objekte ndihmese- 6
- Zjarre të ndryshme (auto, teknike, paisje) 9
- Zjarre malore - 20
- Zjarre fushore - 8
- Zjarre Ushqim Bagetish -06

2. Intervenime të rrejshme : ska

3. Intervenime teknike (aksidente, pastrim etj) 11 dalje

4. Shërbimet të ndryshme (furnizim me ujë, shërbime KKomunal etj) 23 dalje

5. Vëshime : ska patur

Furnizimet

-Puntoret NJPZSH jan furnizuar me uniformë verore dhe dimrore nga MPB/AME

-Furnizimi me material higjenik është bërë me kohë

-Servisimet e automjeteve dhe regjistrimi I tyre eshte kryer me kohe

- Nje barkë ,motor,auto e tipit “Llandrover”,dhe Rimorkio per barke nga MPB-AME

- Me 19- 30 Qershor kemi vizituar bregdetin SHqiptar dhe ate te ndarë në dy grupe me nga 10 Zjarrfiksa,

-Regjistrimi ,sigurimi I automjeteve është bërë me kohe

-Parapergaditjet per Ushtrimin fushor”Mirusha 2017”

-Servisimi I aparateve Zjarrfikse

-Kremtimi i 17 shkurtit dites formimit te NJPZSH te Restorant “Ora”

-Vizita e te gjitha Shkollave Fillore ne teritorin e Komunes Malisheves

- Nga ana e DMSH e kan filluar punen ne NJPZSH me 10 qershor,me kontrate 5 mujorshe